



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Fax : +355 4 232 601. e-mail: ps\_group@parlament.al

Nr. 266/prot

Tiranë, më 29/10/2010

**Z. Ridvan BODE**

**MINISTËR I FINANCAVE**

**Lënda :** Kërkesë për marrje informacioni.

I nderuar zotëri,

Në mbështetje të nenit 48 të Kushtetutës në të cilin thuhet “ Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t’u drejtoj kërkesa, ankesa ose vërjetje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj”;

Në mbështetje të nenit 8 të ligjit “Për Statusin e Deputetit”, në të cilin thuhet “Deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me permbushjen e detyrës së tij, të ministrave ose drejtuesve të institucioneve të tjera qëndrore, si dhe të çdo institucioni tjetër në administratën shtetërore e të qeverisjes vendore. Drejtuesit ose stafet e tyre janë të detyruar t’i përgjigjen deputetit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës” ;

**Kërkojmë :**

- **Vlerën e paguar deri tani për projektin teknik të rrugës Rrëshen – Kalimash.**
- **Vlerën e paguar deri tani për menaxhimin e projektit të rrugës Rrëshen – Kalimash.**

- Vlerën e paguar deri tani për supervizimin e ndërtimit të rrugës Rrëshen – Kalimash.
- Vlerën e paguar deri tani për ndërtimin e rrugës Rrëshen – Kalimash.
- Koston e kredisë sindikale të paguar deri tani, marrë për ndërtimin e rrugës Rrëshen – Kalimash.
- Vlerën e paguar deri tani për projektin teknik të rrugës Kalimash – Kukës – Morinë.
- Vlerën e paguar deri tani për menaxhimin e projektit të rrugës Kalimash – Kukës – Morinë.
- Vlerën e paguar deri tani për supervizimin e ndërtimit të rrugës Kalimash – Kukës – Morinë.
- Vlerën e paguar deri tani për ndërtimin e rrugës Kalimash – Kukës – Morinë.

Presim që brenda afateve që përcakton ligji të kemi informacionin zyrtar të kërkuar.

**Mimi KODHELI**

**DEPUTETË**



Zy. Kesheli -  
17.12.10

KUVENDI  
NR 2665/2 DATE 17.12.10



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E FINANCEVE  
DREJTORIA E PERGJITHSHME E BUXHETIT  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 13249/6 Prot.

Tiranë, më. 13.12.2010

Për: Z. Marlind MYFTIU  
Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit

Subjekti: Dërgohet informacion

Në përgjigje të shkresës suaj nr.2665, datë 29.10.2010, "Kërkesë për marrje informacioni" po ju dërgojmë informacionin e kërkuar mbi investimet në rrugën Rrëshen-Kalimash dhe Kalimash-Kukës-Morinë sipas tabelës bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

Ridvan BODE

  
MINISTER  


<b>Emri i projektit</b>	<b>Vlera (në lekë)</b>
Projekti teknik i rrugës Rrëshen-Kalimash	682,440,030
Menaxhimi i projektit të rrugës Rrëshen-Kalimash	155,017,200
Supervizimi i ndërtimit të rrugës Rrëshen-Kalimash	756,460,948
Ndërtimi i rrugës Rrëshen-Kalimash	117,970,882,365
Projekti teknik i rrugës Kalimash-Kukës-Morinë	87,000,000
Supervizimi i ndërtimit të rrugës Kalimash-Kukës-Morinë	172,714,771
Ndërtimi i rrugës Kalimash-Kukës-Morinë	14,009,927,380
Menaxhimi i projektit të rrugës Kalimash-Kukës-Morinë	-

*Shënim: Për objektin "Menaxhimi i projektit të rrugës Kalimash-Kukës-Morinë" nuk ka pasur fonde nga buxheti i shtetit.*